

# BASHKIA E KOLONJËS

## POZICIONI GJEOGRAFIK:

Bashkia e Kolonjës shtrihet në pjesën jug-lindore të Shqipërisë, midis  $40^{\circ} 05'$  e  $40^{\circ} 29'$  gjerësi gjeografike veriore dhe  $20^{\circ} 27'$  dhe  $20^{\circ} 47'$  gjatësi gjeografike lindore.

Përgjithësisht është një rreth malor me male e kodra të vendosura njëra pranë tjetrës, duke qarkuar si kurorë Gropën e Kolonjës.

Krahina e Kolonjës është më e larta në Shqipëri, me një lartësi mesatare 1100 m mbi nivelin e detit.

Ajo **kufizohet**: nga lindja me Greqinë, kufi që dominohet nga kurrizi malor i malit të **Gramozit**, përgjithësisht i zhveshur me kullota të pasura verore e ku ndodhet edhe maja më e lartë e rrethit: **Cuka e Peçit** 2523 m mbi nivelin e detit. Në jug-përëndim kufizohet me rrethin e Përmetit, kufi që dominohet nga malet e **Radomit** e disa kodra të tjera, të veshura kryesisht me dushkaja. Në jug, ky kufi me rrethin e Përmetit mbyllet me malin e **Postenanit** dhe atë të **Melesinit**. Në veri ajo kufizohet me rrethin e Korçës, duke u ndarë prej tij me pragun magmatik të Qarrit, ose siç njihet ndryshe: “**Qafa e Qarrit**”.

Brenda këtyre kufijve natyrorë, Bashkia e Kolonjës ka një sipërfaqe prej 864.74 km<sup>2</sup>, duke zënë vendin e 17 në shkallë republike.

**Krahina e Kolonjës** është mjaft e copëtuar duke u ndërprerë tërthor nga lumi i Osumit (161 km), i vetmi lumë i krahinës, degët e lumit Vjosë: Langarica e Sarandapori, si dhe një sërë përrenjsh që zbresin nga Mali i Gramozit. Në rrugën e tyre ata formojnë shtretër të thellë e në këmbë të Malit të Gramozit formojnë kone depozitimi me materiale të ngurtë, është kjo arsyeja që në Gropën e Kolonjës niveli i ujrave freatike është shumë i thellë.

Rrethi i Kolonjës ka **klimë** përgjithësisht **me dimër të ashpër e të ftohtë** (mesatarja shumëvjeçare e Janarit 0.60C), dhe në verë të freskët, (mesatarja e Korrikut 19.40C). Reshjet janë të pakëta (800-1000 mm shi në vit) e bien kryesisht në periudhën tetor- dhjetor.

Ndër **burimet ujore nëntokësore** më të dëgjua të kësaj krahine janë: Burimi i Kozelit, ato të Mavrës, i Vllakës, i Laces, i Vodicsës etj. Ndër erërat lokale përmenden: “Goreni i Gjonçit”, “Hasi i Shtikës”, “Grykë e Rehovës”.



# BASHKIA E DEVOLLIT

## POZICIONI GJEOGRAFIK:

**DEVOLLI:** Krahinë gjeografike dhe etnografike në Qarkun e Korçës. Devolli shtrihet në skajin më juglindor të Shqipërisë. Në juglindje dhe verilindje kufizohet me Greqinë (Kufiri shtetëror 83 km, nga të cilat 0.1 km lumor, 1 km liqenor dhe 81.9 km tokësor). Në veri dhe veriperëndim kufizohet me rrethin e Korçës. (Nëpërmjet lartësive që zbresin në liqenin e Prespës dhe kurizin e Moravës, nëpërmjet **grykës së Cangonjit** lidhen me Fushën e Korçës).

Në jugperëndim kufizohet me rrethin e Kolonjës, nëpërmjet pjerësive verilindore të malit të Gramozit. Sipërfaqja: 458.01km<sup>2</sup>, me një shtrirje veri jug: 20 km dhe lindje perëndim deri 10 km.

## Lugina e Devollit:

Fillon me lartësinë rreth 1900 m, në juglindje të maleve të Moravës (lug akullnajor). Deri në fshatin Miras (Bozhigrad) të Devollit është e ngushtë, asimetrike, pastaj ajo zgjerohet dhe në Bilisht gjerësia e saj është më shumë se 7 km. Pas Grykës së Cangonjit hyn në fushën e Korçës. Lumi Devoll në këtë pjesë është me shtrat të cekët. Lugina e Devollit përfshin dhe Korçën, Gramshin, Elbasanin dhe Beratin përshkohet nga lumi Devoll. Ai është degë kryesore e lumit Seman me gjatësi 196 km. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës 3130 km<sup>2</sup>, lartësi mesatare 960m dhe pjerësi 31%. Devolli **buron nga shpati juglindor i Moravës**. Prurja mesatare shumë vjeçare është 49.5m<sup>3</sup>/sek. Pjesa juglindore e krahinës së Devollit është me kodra të buta dhe me fusha të ngushta të cilat shtrihen përgjatë zikzakeve të lumit Devoll.

**Klima:** Tempertura mesatare vjetore 10.20C, me verë të freskët dhe dimër të ftohtë me reshje dëbore (sasia e reshjeve 733 mm).

**Toka:** hyjnë në tipin e tokave të kafenjta dhe aluvionale dhe shumë pjellore. Janë toka në përgjithësi të vaditëshme.



# BASHKIA POGRADEC

## POZICIONI GJEOGRAFIK:

Gjërësia gjeografike veriore  $40^{\circ} 5'$  në fshatin **Lin**, pika më veriore dhe  $40^{\circ} 7'$  fshati **Sterkanj**, pika më jugore e rrethit të Pogradecit. Gjërësia gjeografike lindore  $20^{\circ} 8'$  fshati Alarup, pika më lindore dhe  $20^{\circ} 23'$  fshati Shpellë, pika më perëndimore. Bashkia e Pogradecit ka një perimetër kufi prej 137 km dhe nga ky kufiri tokësor është 113km dhe ujqor liqenor 23.5km. Pogradeci kufizohet në veri me **Bashkinë Përrenjas**, në perëndim me **Bashkinë Gramsh**, në jug me **Bashkinë Maliq**, në juglindje me **Bashkinë Pustec**, ndërsa në lindje me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 548.77 km<sup>2</sup> (fillon në Mal të Thatë me Komunën e Ohrit dhe vazhdon përmes liqenit të Ohrit deri në “Qafë Thanë” dhe tokësor me Komunën e Strugës).

Rrethi i Pogradecit ka klimë mesdhetare paramalore dhe malore. **Temperaturat** mesatare vjetore janë 110 – 80 C. Temperatura mesatare e muajit më të ftohtë është 2.50 C dhe e muajit më të ngrohtë 21.50 C. Temperaturat maksimale më të ftohta janë regjistruar në vitet 2001-2002 rreth – 200 dhe më të ngrohta në vitet 1950 dhe 1983 rreth 400 .

**Pellgu i Pogradecit** është i mbyllur nga zonat malore dhe me liqenin e tij përbën nje zonë mikroklimatike të veçantë. Kjo zonë ka mbi 2400 orë me diell gjatë vitit, pra mbi 300 ditë në vit, rreth 10 muaj temperatura e ujit gjatë muajve të verës shkon nga 210 - 240. Rrethi i Pogradecit renditet në zonat më të thata të Shqipërisë lidhur me reshjet, me një mesatare vjetore më të ulët 765 mm. Stina e vjeshtës dhe dimrit janë më të lagëta, me reshje shiu dhe bore, ndërsa stina e verës është e thatë dhe me shumë pak shira. Erërat tokësore që fryjnë në zonën e Pogradecit janë “**Veriu**” që njihet si era që sjell gjithmonë te ftohtin, “**Juga**”, që sjell të ngrohtin, “**Era e Lindjes**” që vjen nga Mali i Thatë dhe “**Era e Krivecit**”, që është era lokale që del gjithmonë në mesditë dhe mbasdite.

-**Flora dhe fauna e liqenit** janë shumë të pasura dhe e bëjnë këtë liqen me një biodiversitet unikal në Ballkan dhe Europë. Liqeni ka rreth **40 specie dhe nënspecie** të rralla endemike. Liqeni ka origjinë tektonike. Specia më e dëgjuar është Korani (Salmo Letnica Ohridanus Karaman).

**LIQENI I POGRADECIT (OHRIT) / origjinë tektonike. Është liqeni i dytë në Shqipëri për sa i përket madhësisë, pas atij të Shkodrës dhe një nga më të mëdhenjtë në Gadishullin Ballkanik.** Ai gjendet në Shqipërinë juglindore. Ka sipërfaqe 363 km<sup>2</sup> (111.4km<sup>2</sup> brenda kufijve shtetërore të Republikës së Shqipërisë). Shtrihet në lartësinë 693m. Është një nga liqenet më të thellë të Shqipërisë (thellësia mesatare 145 m dhe maksimalja 295m) dhe i Ballkanit dhe një nga më të thellët e Europës.

Ka **vëllim** të përgjithshëm të ujrave 50 miliardë m<sup>3</sup> ujë.

**Sipërfaqja** e pellgut ujëmbledhës është rreth 2800 km<sup>2</sup> .

**Plazhi është zallor dhe ranor.** Kufizohet me Maqedoninë.

Në bregun Perëndimor (shqiptar) gjendet Gadishulli i Linit dhe fshati me të njëjtin emër. Liqeni i Pogradecit ushqehet me ujë nëpërmjet burimeve nëntokësore nga Liqeni i Prespës (Gryka e Zaverit), (liqeni i Prespës gjendet 157m më i lartë), nëpërmjet burimeve që dalin pranë bregut (“Shën Naum”, Drilon, Tushemisht etj), ose nën liqen që kanë prurje të përgjithshme 15m/sek.

**Liqeni i Pogradecit** shquhet në veçanti për pastërtinë dhe tejdukshmërinë e madhe të ujrave (deri 30m thellësi) që kanë ngjyrë të kaltër në blu. Liqeni i Pogradecit është formuar që në Miocen (muze fosilesh të gjalla). Liqeni ka 40 specie dhe nënspecie endemike. Peshku endemik i rrallë KORANI (vetëm në Bajkal), Troftë me pika të kuqe e të tjera të zeza në trup, si dhe Belushka. Ka rosa të egra, pulëzeza, mjelma, e të tjera. **Një nga qendrat turistike më të rëndësishme në Shqipëri.**

Secila zonë pyjore, ose kullusore e rrethit të Pogradecit ka **bimësinë e saj endemike** shumë të pasur, nga të cilat disa janë bimë medicinale si: Mëllaga e egër-Zhumblica-Maraqka-Kokrrat e Dëllinjës së zezë-Fierguri-Lulebasani, e shumë të tjera.



## BASHKIA MALIQ

**Bashkia Maliq** shtrihet në jug-lindje të Shqipërisë , në veri-perëndim të qytetit të Korçës, rreth 13 km larg saj dhe në perëndim të fushës të Korçës përgjatë rrjedhës të lumit Devoll.

Ka një **reliev fushor-kodrinor** në pjesën e qytetit dhe kodrinor-malor në fshatra. Ndodhet në **një lartësi** nga niveli i detit prej 812 m në qendër të qytetit deri në 1.131 m në fshatin Bickë. Pjesët më të larta në territor janë **Mali i Ariut**, 1.379 m, në fshatin **Kolanec** dhe **Maja e Mustaqit**, 1.547m, në territorin e fshatit Gjyras.

**Sipërfaqja** është 656.89 km<sup>2</sup>.

**Qyteti i Maliqit** është ngritur pas tharjes të kënetës dhe ka një moshë rreth 50 vjeçare. Tharja e kënetës ka filluar në vitin 1947 dhe ka përfunduar në 1950 duke përfutur rreth 9000 Ha tokë nga e cila 4500 ha tokë bujqësore.

Por, fillesat e jetës në këtë zonë janë shumë të hershme. Nga studimet gjeologjike ka rezultuar se në afërsi të lumit Devoll është zbuluar një vendbanim Ilir. Po kështu në majën e Gradishtës janë zbuluar muret e një fortifikimi Ilir, fakte që flasin për popullim që në lashtësi. **Maliqi është një zonë e rëndësishme arkeologjike ndër të vetmet në Shqipëri për periudhën e paleolitit të hershëm.** Nga gërmimet arkeologjike aty janë gjetur ndërtesat palafite (ndërtesa me drurë mbi ujë) si dhe shumë sende të rëndësishme me vlerë arkeologjike. Dy pika të tjera arkeologjike pranë tij janë **dy kodrat e Gradishtës** si dhe të **Hijes së Korbit** të cilat në lashtësi kanë qenë dy qytet të hershme në mbretërinë e parë ilire. Pas bonifikimit u popullua nga banorë të krahinave përreth si dhe nga shumë qytete të tjera të Shqipërisë. Menjëherë pas bonifikimit u nis ndërtimi i Kombinatit të Sheqerit, një vepër madhore për ekonominë e Shqipërisë, një kombinat i cili ishte ndër më të mëdhenjtë në gjithë Gadishullin e Ballkanit. Pjesë e tij ishte dhe TEC-i i cili furnizonte me energji qytetin dhe një pjesë të rrethinave përreth.



## BASHKIA PUSTEC

Bashkia Pustec është një Bashki që kufizohet nga 2 shtete, **Maqedoni dhe Greqi**. Bashkia e Pustecit bën pjesë në qarkun e Korçës dhe ndodhet në skajin verilindor të Qarkut.

Bashkia kufizohet në perëndim me bashkitë Pogradec dhe Maliq, ndërsa në veriperëndim dhe lindje me Republikën e Maqedonisë dhe në jug e juglindje me Greqinë. Qendra e kesaj Bashkie është **fshati Pustec** i cili ndodhet në një largësi prej 25 km nga qyteti i Korçës. Pusteci është i alokuar në pjesën jug-perëndimore të liqenit të Prespës dhe është fshati më i afërt me ishullin e Maligradit. **Sipërfaqja e Bashkisë** është 243.6 km<sup>2</sup>. Në Bashkinë e Pustecit ndodhet dhe **Parku Kombëtar i Prespes** me një sipërfaqe prej 27,750,48 hektarë.

Zona e Prespës **shtrihet** në juglindje të Shqipërisë, në brigjet perëndimore të Liqenit të Prespës së Madhe, (pjesa e Shqipërisë), është **zonë kodrinoro-malore**. Në lindje dhe në juglindje kjo zonë kufizohet me Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Greqisë. Kufiri midis tre shteteve ndahet nga ujrat e liqenit. **Lartësia mbi nivelin e detit** është 850 m. Mali i Thatë që e rrethon nga ana perëndimore ka lartësinë 2286 m. Zona e Prespës hyn në klimën mesdhetare malore.

**Temperatura** mesatare e muajit janar varion nga 10C në 20C dhe në disa zona të caktuara, (më të larta), nga -50C deri në -60C, minimumet absolute variojnë nga 100C deri në -150C. Temperatura e ujit të liqenit të Prespës së Madhe dhe të Vogël në dimër zbret deri në 00C.

Në zonën e Prespës **rriten** rreth 1500 lloje bimësh, nga të cilat: 71 lloje drurësh dhe shkurrësh. Ka 6 specie gjitarësh, 10 amfibësh, 15 reptilësh, 183 shpendësh, 11 peshqish, nga të cilët 8 lloje janë endemike.

### **Liqenet: Prespa e Madhe dhe Prespa e Vogël.**

Liqene me prejardhje tektonike, karstike.

Prespa e madhe: 259 km<sup>2</sup>. Nga këto 46.3km<sup>2</sup> i përkasin Shqipërisë. Prespa e vogël 46.8 km<sup>2</sup>, nga e cila 4.3 km<sup>2</sup> ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

**Thellësia e liqeneve** është 54 m dhe me vëllim ujrash 5.2 miliard m<sup>3</sup>. Brigjet janë pjesërisht shkëmborë të lartë (89 km), dhe të ulët (72 km), me plazhe ranore. Ujrat e tepërta shkarkohen në rrugë nëntokësore nëpërmjet të çarave, zgavrave dhe shpellave karstike (Zaver), kryesisht në Liqenin e Pogradecit, i cili ndodhet 157 m më poshtë, si dhe në fushën e Devollit, ku ato shpërthejnë në burimet e Zvezdës. Ujrat e Liqenit të Prespës së madhe janë të shumta e të tejdukshme (rreth 20m). Temperatura në verë arrin 240C, në dimër zbret 0,40C.

**MALIGRADI:** është një ishull i vogël i pabanuar në liqenin e Prespës së Madhe, ku në shek. XIV është ngritur një kishë brenda një guve shkëmbore, (Kisha e “Shën Mërisë”). Kjo kishë është e përmendur për ansamblin me piktura murale bizantine të stilit paleolog – (Dekret 46/1974 – “MaliGrad”, “GolemGrad”)

